

VEPRIMTARIA & PËRGJEGJËSIA SOCIALE



PJESË E  KASTRATI GROUP



PËRMBAJTJA

VEPRIMTARIA ARSIMORE E PROFESIONALE E KOLEGJIT
GJERMAN TË LARTË TË TEKNOLOGJISË

PRAKTIKA/INTERNSHIP/PUNËSIM

AKTIVITETET SOCIAL-KULTURORE

KPGJT, PËRVOJË BASHKËPUNIMI DHE ME
UNIVERSITETE TE HUAJA

KPGJT, PJESËMARRJA NË PANAIRET "WORK & STUDY"

PËRGJEGJËSIA SOCIALE E KPGJT

Kolegji Profesional i Lartë Gjerman i Teknologjisë

GARANCIA PËR TREGUN E PUNËS!

KPGJT - Kolegji Profesional Gjerman i Lartë i Teknologjisë është një institucion i rëndësishëm arsimor në fushën e teknologjisë në Shqipëri. KPGJT u themelua nga Kastrati Group me një qëllim të veçantë: të plotësojë nevojën e tregut për staf të kualifikuar gati për të punuar dhe të punësojë menjëherë studentët më të mirë në kompanitë e grupit.

Ky institucion arsimor në Shqipëri, operon sipas Sistemit Dual të arsimit, duke kombinuar praktikën me teorinë. Ky sistem i arsimit u siguron studentëve një eksperiencë të vërtetë në fushën e tyre të studimit dhe i përgatit ata për tregun e punës duke fituar njohuri teorike dhe aftësi praktike.

KPGJT siguron kurrikulat e fundit austriake dhe gjermane, me trajnues shqiptarë dhe të huaj. Studentët më të mirë që tregojnë aftësi dhe performancë të shkëlqyer gjatë studimeve të tyre, do të kenë mundësinë e punësimit menjëherë pranë subjekteve të Kastrati Group dhe jo vetëm.




www.kpgjt.edu.al | info@kpgjt.edu.al | +355 69 60 99 099

VEPRIMTARIA ARSIMORE E PROFESIONALE E KOLEGJIT GJERMAN TË LARTË TË TEKNOLOGJISË



Studentët e KPGJT Tur 1-Ditor në Metarlugjikun e Elbasanit

Uzina e Ish-Metalurgjikut në Elbasan, ka qenë një ndër epiqendrat kryesore të tureve mësimore të zhvilluara nga studentët e Kolegjit Profesional Gjerman të Lartë të Teknologjisë (KPGJT), pjesë e Kastrati Group. Në datën 25 Prill 2023, studentët e KPGJT patën mundësinë për të vizituar Uzinën e Ish-Metalurgjikut në Elbasan. Kjo vizitë ishte e rëndësishme për studentët, pasi u ofroi një vështrim të afërt në teknologjinë e prodhimit metalurgjik. Uzina e Ish-Metalurgjikut në Elbasan është një prej objekteve industriale më të njohura në Shqipëri, me një histori të pasur dhe një kontribut të rëndësishëm në sektorin e metalurgjisë. Në kohën e funksionimit të saj, ky kombinat ishte një nga prodhuesit kryesorë të çelikut në vend dhe ndikoi në zhvillimin ekonomik të rajonit.



Në këtë vizitë, studentët patën mundësinë të shikonin nga afër proceset e prodhimit metalurgjik. Ata u shoqëruan nga specialistë të fushës dhe u udhëzuan nëpër ambientet e ndryshme të uzinës. Një prej momenteve më interesante ishte vizita në laboratorët e kontrollit të cilësisë. Studentët kishin mundësinë të shihnin testimin e materialeve, analizën e përbërjes së çelikut dhe kontrollet e performancës. Kjo u dha atyre një kuptim të thellë të rëndësisë së kontrollit të cilësisë në prodhimin e metalit. Gjatë vizitës, studentët gjithashtu patën mundësinë të komunikojnin me inxhinierët dhe teknikët e uzinës, duke ndarë mendimet dhe pyetjet e tyre mbi teknologjitë e përdorura dhe sfidat që përballet industria metalurgjike. Ata shfaqën një nivel të lartë të interesit dhe kuriozitetit, duke demonstruar përkushtim ndaj fushës së tyre të studimit.



Për studentët e KPGJT, kjo vizitë ishte një mundësi unike për të parë nga afër teknologjinë dhe praktikën e aplikuar në prodhimin metalurgjik. Ata u frymëzuan për të shfrytëzuar këto njohuri dhe për të përdorur ato në projektet e tyre të ardhshme dhe në karrierën e tyre profesionale. KPGJT vlerëson bashkëpunimin e ngushtë me Uzinën e Ish-Metalurgjikut në Elbasan që vazhdon të ofrojë mundësi të tilla të vlefshme për studentët e saj.

Vizitat industriale si kjo janë pjesë e angazhimit tonë për të siguruar një arsimim praktik dhe të sjellë studentët afër realitetit të fushës së tyre të studimit. Si pjesë e procesit të praktikës u kryen testime në pajisje të matjes së fortësisë, por gjithashtu u vizituan disa prej laboratorëve të Universitetit si:

1. Laboratori i matjeve dhe kontrollit;
2. Laboratori i provave të materialeve;
3. Laboratori i përpunimit të materialeve;
4. Laboratori i konstruktimit dhe dizajnit;
5. Laboratori i automjeteve motorike;
6. Laboratori i mekatronikës.



Një Ditë Praktike Profesionale Ndryshe, Kompania Everest Hap Dyert për Studentët e KPGJT

Studentët e KPGJT, turin e praktikave profesionale e kanë stacionuar në një prej firmave më në zë në kryeqytet, në Kompaninë Everest. Takimi i studentëve në ambientet e firmes u zhvillua në datën 15 Tetor 2022, ku studentët e Kolegjit Profesional Gjerman të Lartë të Teknologjisë (KPGJT) kishin një mundësi për të vizituar kompaninë Everest në Tiranë dhe për të analizuar të gjitha stadet e proceseve të punës që ka firma. Kjo vizitë ishte një përvojë e rëndësishme dhe frymëzuese për studentët, duke i eksponuar ata në botën e prodhimit të aluminit dhe teknologjisë së tij të avancuar. Everest është një kompani lider në prodhimin e profileve të aluminit në tregun e Shqipërisë.

Një kompani me përvojë mbi 25 vjet, Everest ka zhvilluar një reputacion të fortë për cilësinë dhe inovacionin në industrinë e aluminit. Vizita e studentëve të KPGJT filloi me një pritje të ngrohtë dhe mikpritëse nga stafi i Everest, i cili i shoqëroi studentët në një tur rrëfimtar në zonat e prodhimit të kompanisë.



Studentët ishin të mahnitur nga shkalla e avancuar e teknologjisë dhe proceset e prodhimit që shihnin përpara tyre. Në laboratorët e kompanisë, studentët kishin mundësinë të shihnin teknikat e testimit dhe kontrollit, të cilat përdoren për të siguruar cilësinë dhe performancën e profileve të aluminit. Jo vetëm kaq, por ata u njohën me procesin e ekstrudimit dhe modelimin e profileve të ndryshme, duke vënë theksin në detajet dhe aftësinë e kompanisë për të krijuar produkte të përsosura.

Gjatë vizitës, studentët takuan edhe disa inxhinierë dhe specialistë të kompanisë, të cilët ndanë me ta përvojën e tyre në fushën e prodhimit të aluminit dhe dhanë përgjigje për pyetjet dhe kuriozitetet e studentëve. Ata shprehën vlerësimin e tyre për interesin dhe përgjegjësinë që studentët e KPGJT treguan në fushën e teknologjisë së aluminit. Përfundimi i vizitës ishte një moment i frymëzimit dhe motivimit për studentët e KPGJT. Ata u kthyen me një perspektivë të pasur dhe të pasionuar për industrinë e aluminit, duke parë mundësitë dhe sfidat që i presin në të ardhmen e tyre.



Vizita në Everest ishte një hap i rëndësishëm për të kuptuar më mirë fushën e studimit të tyre dhe për të përmirësuar aftësitë dhe njohuritë e tyre në teknologjinë e aluminit. Everest u shfaq si një partner i rëndësishëm për KPGJT dhe studentët e saj. Kjo vizitë tregoi se bashkëpunimi midis institucionit arsimor dhe industrisë është i rëndësishëm për t'ju ofruar studentëve një përvojë të pasur dhe për t'u përgatitur për tregun e punës në fushën e teknologjisë së aluminit. KPGJT vlerëson marrëdhënien e ngushtë me Everest dhe të gjithë partnerët e tjerë të industrisë, duke krijuar mundësi të rëndësishme për studentët për të zhvilluar veten dhe për të fituar njohuri të reja dhe praktike në fushën e tyre të studimit.



Studentët e KPGJT, Vizitë Bashkëpunimi në Universitetin “Hasan Prishtina”, në Prishtinë.

Universiteti “Hasan Prishtina” në Prishtinë, ka qenë destinacioni i tureve të radhës për studentët e KPGJT. Në Qershor të këtij viti, studentët e Kolegjit Profesional Gjerman të Lartë të Teknologjisë (KPGJT) patën mundësinë për të vizituar Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina” në Kosovë.

Kjo vizitë ishte një përvojë frymëzuese dhe e rëndësishme për studentët, duke ju ofruar një përfaqje të re në botën e arsimit të lartë dhe ndarjen e njohurive me studentët dhe profesorët e universitetit tjetër siç ishte ai i Prishtinës.



Studentët e KPGJT u pritën me entuziazëm në Universitetin e Prishtinës dhe nga stafi i universitetit, i cili i shoqëroi ata në një tur të kampusit dhe hapësirave akademike të universitetit. Ata kishin mundësinë për të parë nga afër ambientet mësimore, bibliotekën e universitetit dhe laboratorët e specializuar që ofronin një gamë të gjerë të programeve të studimit.

Gjatë vizitës, studentët e KPGJT patën mundësinë për të ndarë përvoja me studentët e Universitetit të Prishtinës. Ata ndanë historitë e tyre të mësimin në KPGJT dhe përparimin e tyre në fushën e teknologjisë dhe inxhinierisë. Gjithashtu, ata ishin të interesuar për të dëgjuar për eksperiencën e studentëve të universitetit në studimet e tyre dhe në perspektivat e tyre të punësimit. Një nga momentet më të frytshme ishte takimi me profesorët dhe specialistët në fushën e teknologjisë dhe inxhinierisë në Universitetin e Prishtinës. Studentët kishin mundësinë për të dëgjuar prej tyre rreth sfidave dhe mundësive të tregut të punës në fushën e tyre të studimit, si dhe për të mësuar më shumë rreth zhvillimeve më të fundit në këtë fushë.




Përfundimi i vizitës ishte një moment emocionues, ku studentët u kthyen në KPGJT me një perspektivë të re dhe frymëzuese për të ardhmen e tyre. Vizita në Universitetin e Prishtinës u bë një burim i vërtetë frymëzimi dhe dëshirës për të arritur më shumë në fushën e teknologjisë dhe inxhinierisë. Kjo vizitë ofroi një mundësi të vlefshme për të ndarë njohuri, përvoja dhe perspektiva me studentët dhe profesorët e një institucioni të rëndësishëm arsimor. Ky lloj bashkëpunimi dhe shkëmbimi i ideve u rrit përgjegjësinë dhe motivimin e studentëve të KPGJT për të arritur suksesin dhe për të bërë ndryshimin në fushën e tyre të studimit dhe karrierës së tyre në të ardhmen.

PRAKTIKA/INTERNSHIP/PUNËSIM

Praktika e studentëve të KPGJT është dritarja që hap rrugën për të krijuar lidhje me botën e vërtetë të punës dhe profesionit në veçanti në Shqipëri. Dhe këtë lidhje e përfitojnë në mënyrë të menjëherëshme vetëm studentët e kolegjit. Falë mjedisit mësimor me standard evropian dhe nëpërmjet praktikave frytdhënëse në biznese reale të Kastrati Group, KPGJT përgatit studentët për të qenë profesionistët e së ardhmes.

KPGJT fokusohet në suksesin personal të gjithësecilit student që tashmë ka vendosur të bëhet pjesë e auditorëve të kolegjit duke ofruar mbështetjen dhe trajnimin e nevojshëm për t'i ndihmuar ata të arrijnë sukses në fushën që kanë zgjedhur. KPGJT në përmbushje të vizionit dhe misionit të tij strategjik lidhur me pikëtakimin e ofertës akademike me kërkesën e tregut të punës, jo vetëm që u mundëson studentëve kryerjen e praktikave profesionale dhe internshipeve, por edhe pas diplomimit u ofron atyre dhe mundësi punësimi dhe zhvillimi të karrierës së tyre profesionale në firmat e Grupit Kastrati. Kjo mënyre pune është favorizuar falë bashkëpunimeve që KPGJT ka vendosur me Grupin Kastrati duke mos lënë mundësinë edhe me partnerët si sipërmarrje të vogla, të mesme dhe kompani të mëdha vendase dhe të huaja që operojnë brenda vendit.


KPGJT ka një rol ndëraktiv me aktorët e biznesit në kuadër të zhvillimit të praktikave profesionale, punësimit të studentëve, transferimit të njohurive dhe shkëmbimit të ndërsjellë të eksperiencave, për t'i dhënë një vlerë të shtuar arsimit të lartë shqiptar. Nga përvoja e këtij viti duket se studentët janë të prirur pas profesioneve dhe në kolegjin tonë kanë mundur ta gjenë atë. Nga rezultatet e studentëve, një pjesë kanë spikatur që në vitin e parë duke ju krijuar mundësia të punësohen pranë firmave të Kastrati Group.



AKTIVITETET SOCIAL-KULTURORE

Kolegji Profesional Gjerman i Lartë i Teknologjisë (KPGJT) pjesë e Kastrati Group, njihet edhe për aktivitetet socialo-kulturore që prej themelimit të tij. Thelbi i veprimtarisë së kolegjit vendoset mbi ato aktivitete sociale që kanë për qëllim dhënien e mesazheve të rëndësishme si: përkujdesja, përkushtimi, dhurimi, altruizmi, dashuria apo çfarëdo lloj ndjesie tjetër shpirtërore nga studentët për studentët. Falë vendosjes së këtyre qëllimeve, studentët e KPGJT ju janë gjendur pranë mjaft familjeve që janë përballur me problematika të mëdha siç ishte fatkeqësia natyrore e tërmetit, dhe ato të pandemisë. Studentët e KPGJT janë bërë bashkë në çdo ditë të rëndësishme të vitit kalendarik dhe në çdo ditë të saj do të kenë të dokumentuar një kujtim.

Duke qenë pjesë e Kastrati Group ata kanë kuptuar më nga afër rëndësinë dhe përgjegjësinë ndaj komunitetit që na rrethon. Studentët kanë marrë pjesë në shumë evente dhe kanë kapërcyer përtej kufijëve për të kuptuar e mësuar më tepër prej kulturave të ndryshme që na rrethojnë. Diversiteti i këtyre aktiviteteve në KPGJT forcon dhe fuqizon kontributin e çdo studenti duke inicjuar ndërgjegjësim, përgjegjshmëri dhe qëndrime njerëzore ndaj fenomeneve të botës që na rrethon e duke marrë prej tyre më të mirën.



www.kpgjt.edu.al | info@kpgjt.edu.al | +355 69 60 99 099

KPGJT, PËRVOJË BASHKËPUNIMI DHE ME UNIVERSITETE TE HUAJA

Sa më shumë njohuri të fitoni, aq më shumë mundësi do të hapen për të arritur mundësitë më të mira në karrierë dhe rritje personale të gjithësecilit prej jush. Behuni pjesë e KPGJT dhe e ardhmja juaj do të marrë rrugën e duhur.

KPGJT ofron ambiente moderne, standarde bashkëkohore dhe mjedise reale laboratorike për trajnim dhe praktikë të avancuar, të cilat drejtohen me mjeshtëri nga një staf i kualifikuar i pedagogëve shqiptarë dhe të huaj. Mësimdhënia realizohet në stenda trajnimi dhe modele funksionale me komponentë origjinalë, të orientuara nga praktika. KPGJT ofron një ambient mësimor të frytshëm duke ndërthurur veprimtaritë praktike me orët mësimore për të marrë gjithë njohuritë e nevojshme. Jo vetëm kaq, por kolegji kombinon njohuritë dhe praktikën duke ju ofruar studentëve një kualifikim që plotëson plotësisht kërkesat e kompanive të sotme.

Përvec standardeve evropiane, KPGJT ka nisur bashkëpunime me partnerë të fushës. Duket se bashkëpunimi me Fh. Joanneum, University of Applied Sciences dhe St. Polten, University of Applied Science do të sjellë shumë avantazhe për KPGJT dhe studentët. Këto universitete kanë një reputacion të mirë në fushat e tyre të specializimit dhe mund të ofrojnë mundësi të rëndësishme për studentët e kolegjit për të zhvilluar njohuritë e tyre dhe për të ndërtuar rrjetet e tyre profesionale.



KPGJT ofron mundësinë e arsimimit dhe përgatitjes së studentëve si profesionistë me aftësi praktike për tregun e punës si brenda dhe jashtë vendit. Për të ofruar rezultate maksimale në mësimdhënie, është krijuar një program studimi i udhëhequr nga pedagogë dhe ekspertë të huaj nga Gjermania, Austria, Zvicra dhe më gjerë.

-Praktika profesionale të garantuara në ndërmarrje.

-Pedagogë dhe ekspertë të huaj nga Gjermania, Austria, Zvicra.

-Sistemin Dual i mësimdhënies me kurrikula të përditësuara sipas standardeve evropiane

-Mundësi shumë të larta punësimi në sistemin e ndërmarrjeve pjesë e "Kastrati Group"



www.kpgjt.edu.al | info@kpgjt.edu.al | +355 69 60 99 099

KPGJT, PJESËMARRJA NË PANAIRET “WORK & STUDY”

KPGJT, Merr Pjesë në Panairin “Work & Study” Organizuar nga Dhoma e Tregëtisë në Kukës

“Work & Study”, panairi i mundësive për profesione e punësim, ku KPGJT mirëpriti të gjithë të interesuarit që e shohin institucionin tonë si investimin dhe opsionin më të mirë për të ardhmen e tyre! Panairi “Work & Study”, është konceptuar si një panair lëvizës, i cili këtë vit ka shkuar në disa qytete të vendit. Ndalesa e radhës ishte qyteti i Kukësit, ku përmes këtij panairi maturantët kanë mundur të njihen më nga afër me ofertat e ndryshme të institucioneve arsimore pjesmarrëse në panair. Në panair maturantët kishin mundësi të informohen për opsionet që ju ofrohen dhe më pas ata do ta kenë më të lehtë të bëjnë zgjedhjen e duhur për të ardhmen e tyre.

Panairi është hartuar në mënyrë tillë që dijet dhe ofertat cilësore për studim dhe punësim të takohen me sipërmarrjen konkrete, jo vetëm kaq, por ky panair iu jep mundësinë të rinjve që të orientohen dhe të zgjedhin për të ardhmen e tyre drejt profesioneve. Qëllimi i këtij eventi ishte punësimi dhe orientimi i studentëve drejt profesioneve që kërkon tregu i punës. Përmes këtij panairi, përfaqësuesit e KPGJT, falë kontaktit të drejtpërdrejtë me maturantët mblodhën informacione dhe qartësuan çdo detaj rreth ofertave të bizneseve dhe mundësie për t’u bërë pjesë e KPGJT, duke hedhur hapa në rrugën drejt përcaktimit të së ardhmes.

Mes larmishmërisë dhe përputhjes së kërkesave të tyre, studentët e ardhshëm do të kenë mundësi zgjedhjeje, jo vetëm të arsimohen, por edhe të punojnë pranë firmave të Grupit Kastrati. Siguri dhe mundësi që njëherë të jepet në jetë. Stenda e “KPGJT” u vizitua nga një numër i konsiderueshëm maturantësh, ku gjithësecili prej tyre u informua për çdo detaj dhe mundësi ndryshe që kolegji favorizon.

“Work & Study” Elbasan



KPGJT, Pjesëmarrës dhe në Panairin “Work & Study” në Shkodër

Në Shkodër, gjatë panairit “Work & Study” në kuadër të këshillimit të karrierës me skuadrën e KPGJT, maturantët patën mundësi të marrin këshilla dhe oferta shumë të dobishme për përzgjedhjen e degëve të profesioneve që ata mendojnë të ndjekin. Të pranishëm ishin mbi 250 maturantë nga i gjithë rrethi i Shkodrës, të cilët u informuan rreth programeve të studimit që Kolegji Profesional I Lartë I Teknologjisë ofron për ta. Në stendën e KPGJT u mor informacion mbi ofertën akademike 2023-2024.

Maturantët kishin mundësi të takonin përfaqësues të Kolegjit, të cilët ishin të gatshëm të informonin të gjithë ata që shprehën dëshirën për të njohur Kolegjin, i cili ushtron aktivitetin e tij akademik nëpërmjet një platforme të pasur dhe shumë cilësore të fokusuar më shumë në zhvillimin profesional. Gjatë komunikimit të hapur me maturantët, Përfaqësuesit e Kolegjit ju përgjigjën të gjitha pyetjeve dhe shqetësimeve që ata kishin në lidhje me vazhdimësinë e studimeve të tyre. Më tej u njohën edhe me mundësinë për tarifat dhe bursat që ofrohen si dhe mbi kriteret e pranimit, aplikimi për bursa studimi dhe mundësi për të thelluar më tej studimet. Panairi e tilla ku ka marrë pjesë KPGJT përbëjnë një nga mundësitë që kolegji mund të shfrytëzojë për t'u ekspozuar me ofertat dhe shërbimet dhe për të marrë eksperiencë nga të tjerët.

“Work & Study” Shkodër



“Work & Study” Lezhë

“Work & Study” Tiranë



www.kpgjt.edu.al | info@kpgjt.edu.al | +355 69 60 99 099

GALERIA "WORK & STUDY"

"Work & Study" Berat



"Work & Study" Kavajë

"Work & Study" Krujë



"Work & Study" Librazhd

"Work & Study" Vlorë



www.kpgjt.edu.al | info@kpgjt.edu.al | +355 69 60 99 099

KPGJT, MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI ME AGJENCINË E RINISË, PËR PAJISJEN ME KARTAT E STUDENTIT

Kolegji Profesional Gjerman i Teknologjisë firmos marrëveshje bashkëpunimi me Agjencinë e Rinisë, pranë Bashkisë Tiranë, për Kartat e Studentit. Numri i bizneseve që ofrojnë shërbime apo produkte me çmime të reduktuara për të rinjtë me Kartë Studenti shtohet çdo ditë. Drejtuesit e KPGJT nënshkruan një marrëveshje bashkëpunimi me Agjencinë e Rinisë, e cila u vjen në ndihmë të gjithë studentëve në kryeqytet për mundësitë e reja që përcjell kolegji më i ri në kryeqytet.

Studentët e pajisur me kartën e studentit do të kenë mundësi të përfitojnë tarifa të reduktuara deri në zero për shërbimet bankare. Çdo student i pajisur me kartë do të përfitojë shërbime dhe produkte me çmime të reduktuara ose deri dhe falas, të ofruara nga vetë Firmat e Grupit Kastrati apo edhe institucione të tjera publike dhe partnerë, të cilët bëhen pjesë e këtij programi. Kjo marrëveshje synon edhe krijimin e një kulture të re tek të rinjtë që të përkujdesen për çdo mundësi që ju jepet nga kolegji.

Drejtuesit e Kolegjit theksuan se përmes kartës së studentit, të rinjtë do të mund të marrin një gamë të gjerë të shërbimeve falas ose me çmime tepër të ulëta në të gjithë rrjetin e Kastrati Group.




www.kpgjt.edu.al | info@kpgjt.edu.al | +355 69 60 99 099

PËRGJEGJËSIA SOCIALE E KPGJT

Kolegji Profesional Gjerman i Teknologjisë, një Godinë dhe Ambient me Standarde Evropiane

Kolegji KPGJT është institucioni i parë jopublik i arsimit të lartë në Shqipëri, i cili është themeluar nga Kastrati Grup, për të krijuar rrethana të reja ekonomike-sociale e kulturore, për të krijuar kushte dhe rrethana për jetën normale të studentëve që janë dhe ato që duan të bëhen pjesë e këtij kolegji. Në kuadër të aktiviteteve të vazhdueshme të KPGJT që shkojnë në favor të komunitetit dhe shoqërisë, është rehabilitimi i gjithë zonës përreth godinës së objektit të kolegjit, gjithë qëllimi i këtij misioni është krijimi i kushteve të favorshme për studentët. Kolegji Profesional Gjerman i Teknologjisë është hartuar e krijuar si një kolegji i veçantë për studentët që duan, jo vetëm të marrin një profesion për të siguruar të ardhmen, por dhe ta sigurojnë atë menjëherë.

E arreduar me një dizajn modern, godina e Kolegjit ofron internet falas (free wifi) dhe mundësinë e karikimit të telefonit në cdo ambient. Në bashkëpunim edhe me Grupin Kastrati, janë mbjellë pemë dhe bimë të tjera dekorative, për t'i shtuar kështu studentëve dhe zonës përreth më shumë gjelbërim. Përveç godinës moderne dhe kushteve të standardeve evropiane, nisma e kolegjit me ndihmë të firmave të Grupit Kastrati ka kontribuar dhe në rehabilitimin e rrugës që lidh kolegjin me bizneset më të afërta. Njëkohësisht ka krijuar dhe kushtet e domosdoshme ndaj studentëve dhe pedagogëve për mundësi parkimi dhe akomodimi gjatë mësimdhënies.



Studentët e KPGJT, pas Vitit të Parë Përfitojnë Direkt Vend Pune

Studentëve të KPGJT, “fati iu ka buzëqeshur menjëherë”. Menjëherë pasi kanë mbaruar vitin e parë të kolegjit një numër i konsideruar studentësh që kanë spikatur në fusha të ndryshme kanë mundur të punësohen menjëherë pranë firmave të Grupit Kastrati.

“Jam shumë i lumtur dhe iu bëj apel të gjithë moshatarëve të mi që të bëjnë zgjedhjen e duhur dhe të zgjedhin KPGJT. Ky kolegji është një mundësi e artë për të gjithë të rinjtë që duan të kenë një zanat që ju fal të ardhura. Jo vetëm kaq ,por frytet e këtij arsimit i merr në mënyrë të menjëhershme. Jemi një grup studentësh që jemi punësuar në firmat e Kastrati Group.”, tregon njëri prej studentëve të kolegjit.



Sipas drejtuesve të kolegjit janë rreth 6 studentë që kanë mundur të fitojnë sistematikisht vendin e punës në profesionet që ato tashmë kanë përzgjedhur. Kolegji e ka bërë traditë të konsoliduar sigurimin e vazhdueshëm të intershipeve dhe punëve part-time për studentët.

Dhe jo vetëm kaq, por ata më të mirët sot po punojnë në firmat e Grupit Kastrati, kjo i ka ndihmuar të gjejnë një punë që në bankat e shkollës apo të jenë pjesë e stazheve në kompanitë me emër të Kastrati Group.



PJESË E  KASTRATI GROUP

GARANCIA PËR TREGUN E PUNËS!

KONTAKT

www.kpgjt.edu.al | info@kpgjt.edu.al | +355 69 60 99 099